



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, zhvilluar në datën 29 janar 2019.
2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11054, datë 14.01.2019 për kthim dhe rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Oerd Bylykbashi, Dhurata Çupi, Silva Caka, Edlira Bode dhe Nasip Naço.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Gent Strazimiri, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Bledar Dervishaj - këshilltar për Çështjet Ligjore i Presidentit të Republikës

Agnes Bernhard – Shefja e misionit EURALIUS

Tedi Dobi – ekspert vendas i misionit EURALIUS

Mimoza Sadushaj – përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë

Irena Laha - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë

Merita Prifti - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë

Elona Saliaj - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me dy çështjet që kemi në rendin e ditës: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit, zhvilluar në datën 29 janar 2019, dhe shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11054, datë 14.01.2019 për kthim dhe rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku komisioni ynë është komision përgjegjës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit. Dakord me procesverbalin? Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes të komisionit të zhvilluar në datën 29 janar 2019.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11054, datë 14.01.2019 për kthim dhe rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”. Siç e thashë pak më parë, komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegia Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Presidenca zoti Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit të Republikës për çështjet ligjore, nga misioni EURALIUS zonja Agnes Bernhard, shefe e misionit dhe Tedi Dobi, ekspert vendas; nga Dhoma Kombëtare e Noterisë zonja Mimoza Sadushaj, kryetare e Dhomës dhe stafi që e shoqëron.

Pa humbur kohë, do t’ia kaloj fjalën përfaqësuesit të Presidentit për të bërë një parashtrim të arsyeve, për të cilat Presidenti ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, e më pas do t’ia kaloj fjalën koleges Vasilika Hysi.

Bledar Dervishaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ligji nr. 110 “Për noterinë” u administrua në institucionin e Presidentit të Republikës në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Ai iu nënshtrua një vlerësimi të thelluar të të gjitha dispozitave të tij.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së këtij ligji, Presidenti në përfundim ka vlerësuar se disa dispozita, ky është një ligj i gjatë, nuk janë të plota dhe paraqesin paqartësi në formulimin e tyre, çka mund të sjellë që në praktikë aplikimi i tyre mund të cenojë parimet dhe standardet kushtetuese.

Jo të gjitha dispozitat paraqesin probleme, ne e kemi parashtruar të gjithë qëndrimin tonë shterues me shkrim prej 11 faqesh dhe kemi vlerësuar se vetëm nenet 61, 65 dhe 76 të këtij ligji paraqesin të meta, të cilat duhet të rivlerësohen nga Kuvendi, me qëllim plotësimin e tyre.

Një pjesë e këtyre dispozitave kanë moskoherencë mes vetë dispozitave të tjera të këtij ligji. Unë po citoj vetëm qëndrimet e tri pikave kryesore, sepse, nëse do ta lexoja të gjithë materialin, do të merrte më shumë kohë, ndërkohë që tashmë të gjithë deputetët e kanë në dispozicion atë: në vlerësimin tonë përmbajtja e nenit 61 të ligjit për noterinë nuk është i qartë dhe në harmoni me disa nene të tjera të këtij ligji. Formulimi i këtij neni nuk parashikon procedurën sesi do të zbatohet ai në praktikë, si dhe nuk përmban asnjë parashikim të shprehur që ligji t'ia njohë të drejtën ministrit të Drejtësisë, që në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e tij me qëllim qartësimin e të gjithë procedurës se si realizohet ky proces. Në lidhje me këtë konstatim ka një material shterues konstatues me 6 arsye përse ndodhen në tryezën tuaj.

Për më tepër, problematikë është konstatuar edhe neni 65, që në vlerësimin e Presidentit të Republikës nuk garanton një trajtim të barabartë të noterëve përballë kostos që duhet të përballojnë për sigurimin e veprimtarisë së tyre, si dhe gjatë zbatimit në praktikë mund të krijojë një deformim në tregun e sigurimeve referuar veprimtarisë noteriale.

Sa i takon nenit 76, në vlerësim të Presidentit, ky është një nen i paformuluar plotësisht dhe për këtë nuk ofron siguri ligjore për mbrojtjen dhe mbështetjen e shtresave të pamundura të shoqërisë, apo të kategorive të veçanta për të përballuar të gjitha tarifat dhe shpenzimet noteriale.

Presidenti e ka mbështetur zgjedhjen që ka bërë Kuvendi për hartimin e një ligji tërësor të ri, sepse ky ishte draft për disa ndryshime në ligjin ekzistues, por nga vlerësimi ynë rezultoi se këto 3 nene paraqesin problematikë. Në këtë mënyrë, Presidenti ka vlerësuar dhe fton Kuvendin t'i rishikojë edhe një herë këto nene, me qëllimin e vetëm, përmirësimin e tyre në funksion të të gjithë draftit.

Nuk do të doja të zgjatesha më tepër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Nga Dhoma Kombëtare e Noterisë fjala për zonjën Sadushaj, qëndrimi juaj në emër të Dhomës, lidhur me arsyet e kthimit të ligjit nga Presidenti.

Mimoza Sadushaj – Faleminderit!

Kemi parë të gjitha arsyetimet që ka bërë Presidenti në lidhje me nenet 61, 65 dhe 76. Ne si Dhomë mendojmë se ligji i ka parashikuar të gjitha rastet, pra, në qoftë se flasim për nenin 61, ka parashikuar që kemi dy lloj pezullimesh, rastin kur noteri pezullohet për arsye të marrjes së masës disiplinore, dhe rasti i dytë është kur noteri kërkon vetëpezullim për arsye shëndetësore, lindjes së një fëmije ose të shkuarjes në një detyrë tjetër.

Ky nen i ka parashikuar të gjitha këto raste dhe qëllimi i tij në këtë ligj nuk është të shohim se çfarë do të bëjë noteri me zyrën e tij, por që t'i ofrohet shërbim qytetarit.

Në këtë nen është parashikuar që ky shërbim dhe administrim i zyrës do të bëhet në dy raste kryesore: me testamentet që ndodhen në zyrën noteriale dhe me administrimin e arkivës së noterit, sepse tek e fundit është qytetari ai që pengohet në realizimin e të drejtave të tij. Pra, në qoftë se noterit i mbyllet zyra, qytetari mbetet pa realizuar dëshminë e trashëgimisë në rastin e një testamenti, sepse ligji kërkon që kjo dëshmi, detyrimisht duhet të lëshohet në këtë zyrë; kemi edhe rastin e arkivës noteriale.

Pra, ne nuk jemi dakord me arsyetimin e bërë nga Presidenti.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjala për zonjën Bernhard, nga misioni EURALIUS, qëndrimi juaj lidhur me arsyet e kthimit të ligjit në Kuvend nga Presidenti.

Agnes Bernhard – Dot të përpiqem të bëj një analizë të shkurtër. Ligji përpiqet të bëjë një balancë proporcionale të interesave të elementeve të ndryshëm dhe ne besojmë se ky ligj arrin të krijojë balancën e duhur.

Këto zgjidhje përdoren në rastin e ndjekjes së një noterit nga prokuroria dhe janë zgjidhje që gjenden në mënyrë të ngjashme edhe në vendet e tjera europiane.

Detyrimi për të pasur siguracion profesional dhe sigurim në kolektiv është në fakt një detyrim europian dhe dispozita të tilla gjenden edhe në legjislationet e vendeve të tjera përkatëse.

Për ne, neni, i cili merret me uljen e tarifave noteriale për grupet e caktuara në nevojë, është një, i cili bën balancën e duhur ndaj aksesit në drejtësi të publikut dhe rolit të noterit, si një funksion publik i dedikuar, i ushtruar në mënyrë të pavarur.

Pa qenë nevoja të futemi në teknikalitete, ne besojmë se është në përputhje me standardet europiane.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bernhard!

Po ia kaloj fjalën koleges Vasilika Hysi, si relatores, për të dhënë edhe ajo argumentet e maxhorancës në lidhje me kthimin e ligjit nga Presidenti.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit përfaqësuesve të institucioneve!

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë” në seancën e datës 20 dhjetor. Bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti ka vendosur ta rikthejë ligjin për rishqyrtim lidhur me 3 nene: 61, 65 dhe 76.

Presidenti i Republikës në relacionin që shoqëron dekretin e tij, e vlerëson ligjin si një akt ligjor pozitiv në drejtim të zhvillimit të sistemit noterial shqiptar, por me paqartësinë që përmbajnë disa nene të veçanta, konkretisht nenet 61, 65 dhe 76, që në vlerësimin e Presidentit të Republikës këto paqartësi mund të sjellin keqinterpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit në praktikë.

Lidhur me përmbajtjen e nenit 61 të ligjit për noterinë, ky nen bën fjalë për zyrën e noterit në rast pezullimi dhe rregullon dy momente që janë të rëndësishme: çfarë do të ndodhë me arkivën e një zyre të noterit kur noteri është pezulluar dhe kur kërkohet çelja e dëshmisë testamentare. Çështjet e tjera janë rregulluar në pjesën tjetër të ligjit.

Argumentet që paraqet në dekret Presidenti janë në mënyrë të përmbledhur, sikurse i ka përshkruar në relacion. Ky nen nuk është në harmoni me dispozitat e tjera të këtij ligji. Nuk është parashikuar procedura si do të zbatohet në praktikë administrimi i zyrës së një noterit nga një noter tjetër, ose nga zëvendësnoteri; nuk është e qartë se me cilat mjete dhe elemente formale identifikimi do të ushtrojë veprimtarinë zëvendësministri; mënyra si do të trajtohet zëvendësnoteri gjatë periudhës së zëvendësimit; administrimi i zyrës nga një noter tjetër në kushte konkurrence mund të jetë ndërhyrje në aktivitetin e noterit të pezulluar.

Lidhur me argumentet e mësipërme të Presidentit të Republikës vlerësoj se ligjvënësi, në konceptimin e kësaj dispozite, ka vlerësuar si parësor dhe të rëndësishëm interesin publik në raport me interesin e noterit.

Së dyti, ligjvënësi ka vlerësuar efektivitetin dhe vazhdimësinë e shërbimit noterial si një shërbim me vlerë të veçantë për shoqërinë dhe jo në çdo rast, por për dy raste: kur një transaksion

ka filluar, për shembull, qytetari ka paguar paratë për një akt shitblerje prone, paratë janë në llogarinë e noterit të pezulluar, pala shitëse do të marrë pagesën për një transaksion të kryer.

E dyta, bëhet fjalë për çelje të dëshmisë testamentare. Për aq kohë sa mund të pezullohet një noter për një afat të caktuar me ligj, qytetari nuk mund të rrijë peng, sepse e dini që dëshmia testamentare ka lidhje me një sërë transaksionesh dhe të drejtash të tjera.

Gjithashtu, neni 61 duhet lexuar në raport me nenet 66 dhe 67 të këtij ligji. Të drejtat dhe detyrat e zëvendësnoterit janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 66, ndërsa lidhur me arkivën e një noterit se çfarë ndodh në rast mbylljeje të përkohshme apo të përhershme të një zyre noteriale, përcaktohet qartë si veprohet dhe në pikën 3 thuhet: “Rregullat e hollësishme për dorëzimin e arkivës rregullohen me akte nënligjore”, pra shqetësimi që ngre Presidenti i Republikës se ligji nuk përcakton rregulla se kush do t’i detajojë, çfarë do të ndodhë me arkivën, me çfarë mjeti identifikimi do të punojë noterit, nuk qëndrojnë, sepse janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në nenet 66, 67 dhe në nenin e fundit të dispozitave kalimtare ku ministri i Drejtësisë ngarkohet të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore brenda 9 muajve për të rregulluar aspektet e veçanta që përmenden në çdo nen të këtij ligji.

Gjithashtu, ajo që do të doja të theksoja është fakti pse është parashikuar kjo dispozitë. Kjo nuk ka ardhur vetëm si një sugjerim ekspertëve të Dhomës Europiane të Noterisë, kryesisht të Dhomës Gjermane, të misionit EURALIUS, por në konsultimin publik të projektligjit të gjithë noterët ngritën si shqetësim se kanë probleme me noterët që nuk dorëzojnë arkivat dhe sot e kësaj dite ka shumë noterë, që nuk i kanë dorëzuar arkivat e tyre, megjithëse ushtrojnë funksion publik të deleguar, mund të kenë ndërruar jetë, a mund të kenë ikur në drejtim të paditur. Në këtë kuadër, edhe në përputhje me dispozitat kushtetuese, raporti i interesit publik me të drejtat e individit, në këtë rast kemi të bëjmë me një funksion publik të deleguar të noterit, prevalon interesi publik.

Nga ana tjetër, ligji nuk parashikon si rregull të përgjithshëm caktimin e një noterit ose zëvendësnoterit si administrator të zyrës. Do të doja t’ju sillja në vëmendje, këtë e kam për zotin Dervishaj, që e drejta për të pasur zëvendësnoter është e drejtë dhe jo detyrim, pra një noter nuk është i detyruar të ketë një zëvendësnoter, kjo është zgjedhja e tij. Kërkesa për të pasur një zëvendësnoter është kërkuar gjatë konsultimit publik nga shumë noterë dhe, duke pasur parasysh që zëvendësnoteri nuk është ai asistenti që kemi sot, që në shumicën e rasteve mbahet në punë të zezë, ai nuk ka kaluar të gjithë periudhën e kualifikimit, formimit, konkursit, e të tjera, mendoj se neni 61, apo shqetësimi që ngre për të Presidenti i Republikës, duhet të shihet ngushtë me të gjithë

kreun që bën fjalë për përgatitjen e zëvendësnoterit. Në ligj kemi parashikuar sistemin e karrierës, pra një zëvendësnoter para se të bëhet i tillë, duhet t'i nënshtrohet një provimi hyrës konkurrues, do të bëjë një formim fillestar të detyrueshëm një-vjeçar, do të bëjë dy vjet praktikë pranë një noteri, dhe këtu kemi shmangur edhe konfliktin e interesit që procesi dy-vjeçar i praktikës profesionale dhe vlerësimi, të mos bëhet nga babai, vëllai apo motra, por nga një noter që nuk është në konflikt interesi dhe në fund fare, ka provimin e kualifikimit për t'u bërë zëvendësnoter, madje edhe kur merr provimin e kualifikimit, kjo nuk do të thotë që ai do të punojë nëse nuk e fton një noter.

E dyta, detyrat e zëvendësnoterit janë të përcaktuara qartësisht në ligj dhe, po të shikoni, ai punon me vulën, dokumentet e noterit dhe me autorizimin e tij dhe përcaktohet qartë se si vepron dhe çfarë vlere kanë dokumentet që përgatit një zëvendësnoter.

Në lidhje me pikën e parë, do të doja të theksoja që argumentet që ka paraqitur Presidenti i Republikës nuk janë në harmoni me gjithçka tjetër që është thënë në këtë ligj. Neni 61, si dhe nenet e tjera të pozicionit të zëvendësnoterit, në vlerësimin tonë kanë një lidhje logjike me njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, për aq kohë sa ligji autorizon Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, që të hartojnë aktet nënligjore, ndërkohë që kompetencat e zëvendësnoterit janë të përcaktuara qartësisht, rastet e pezullimit dhe veprimi i zëvendësnoterit ose një noteri lidhur me arkivën dhe testamentin, janë të përcaktuara qartësisht, jam e mendimit që argumentet e presidentit për nenin 61 nuk qëndrojnë.

Lidhur me përmbajtjen e nenit 65, ky nen, të nderuar kolegë, dhe këtë e kam edhe për të gjithë përfaqësuesit që ndjekin seancën, meqenëse është seancë publike dhe me interes, ka të bëjë me sigurinë e noterit. Çfarë do të thotë? Që noteri duhet të mbajë përgjegjësi për të gjitha veprimet dhe dëmet që i shkakton qytetarit, personave fizikë dhe juridikë. Deri më sot, e dini që shumë noterë kanë kryer veprime abuzive, janë bërë pjesë e transaksioneve, e shitjeve, rishitjeve të banesave, të trojeve dhe pronave publike. Këtu dua të ndaj pjesën e pastër, me integritet të noterëve nga pjesa tjetër.

Në ligjin që ka qenë në fuqi, noterët kanë qenë të detyruar që të bënin sigurimin e përgjegjësive të tyre profesionale. Këtë e kanë pasur edhe avokatët, edhe noterët dhe për çdo gabim që ata bënin në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, qytetari duhej të dëmshpërblehej, kompania po ashtu për transaksionet e bëra në kundërshtim me ligjin. Asnjë noter, nuk e ka ushtruar këtë të drejtë. Këtë problem e kemi pasur edhe me avokatët, dhe pala e dëmtuar është gjithmonë qytetari

dhe interesi publik. Në këtë kuadër, neni 65 ka ardhur i riformuar. Ka pasur një debat të madh për këtë nen dhe një konsultim të gjerë me ekspertë ndërkombëtarë dhe ekspertë të misionit EURALIUS. Ligji ka mundësuar dy opsione: së pari, noteri përpara se të fillojë ushtrimin e funksionit të tij, lidh një kontratë sigurimi të përgjegjësisë profesionale me një kompani sigurimi vendase ose të huaj në mënyrë individuale dhe nëse nuk dëshiron në mënyrë individuale, merr një vendim që për të ulur kokën, për të pasur një kompani ku të përfitojnë lehtësira e të tjera, mund ta bëjë edhe me kontratë kolektive, është zgjedhja e tij. Pra, ose në mënyrë individuale, ose mbi një kontratë kolektive.

Presidenti i Republikës në lidhje me nenin 65 është shprehur se: “Parashikimet nuk garantojnë trajtim të barabartë të noterëve përballë postës që do të duhet të përballojnë për sigurimin e veprimtarisë së tyre, si dhe mund të bëjnë një deformim në tregun e sigurimeve, referuar sigurimit të veprimtarisë së noterëve”. Sikurse jua lexova, të nderuar kolegë, dispozitën, çdo noter në radhë të parë duhet të përmbushë detyrimin e tij ligjor që të bëjë sigurimin e përgjegjësisë profesionale të tij. Ne duhet të shqetësohemi, ky është edhe një gabim i madh yni që nuk kemi mundur të ushtrojmë mjetet e kontrollit parlamentar nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë për të parë se si noterët i kanë respektuar dhe i kanë paguar dëmet ndaj qytetarëve ose kompanive.

E dyta, një parashikim të tillë të ngjashëm, që ne e kemi te neni 65, e kanë ligjet e vendeve të Bashkimit Europian. Në këto vende kjo dispozitë nuk është quajtur se cenon konkurrencën apo trajtimin e barabartë të noterëve.

Ky përfundim që po ju them gjën mbështetje edhe te problematika e evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë. Nëse do t’i referohemi analizës që i është bërë sistemit të drejtësisë në të gjitha konsultimet publike, ka rezultuar që noterët janë borxhli ndaj qytetarëve për veprimet që ata kryejnë dhe jo qytetarët ndaj noterëve. Prandaj, kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale duhet bërë, ajo se cila do të jetë vlere përkatëse është rregulluar në dispozitat ose në paragrafët e tjerë. Në radhë të parë duhet të lexojmë nenin 65, paragrafi 1 në raport me paragrafin 2 të këtij neni, ku flitet për vlerën përkatëse, cili merr vendim dhe cila është vlere, shuma minimale e mbulimit. Njëkohësisht, kjo përcaktohet edhe në aktet nënligjore nga ministri i Drejtësisë, pasi është marrë më parë mendimi me shkrim i Dhomës.

Gjithashtu, lidhur me këtë nen do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë, që ligji dhe ne si ligjvënës kemi pasur parasysh interesin publik, prandaj është e rëndësishme të

theksojmë se modeli i sigurimit kolektiv, që praktikohet në shumë vende europiane, nuk bie ndesh. E para.

E dyta, çdo noter ka të drejtë të zgjedhë mënyrën e sigurimit të tij.

Në këtë kuadër argumentet që sjell Presidenti i Republikës, në vlerësimin tonë nuk qëndrojnë.

Neni i fundit është neni 76 i ligjit. Neni 76 i ligjit bën fjalë për përjashtimin nga shpenzimet noteriale. Presidenti i Republikës shprehet: “Formulimi i këtij neni nuk është i qartë dhe nuk ofron siguri ligjore për mbrojtjen dhe mbështetjen e shtresave të pamundura të shoqërisë, për të përballuar tarifatat dhe shpenzimet noteriale ose të kategorive të veçanta të shoqërisë”. Lidhur me këtë argument ose arsyet që sapo ju lexova, që i përkasin relacionit të sjellë nga ana e Presidentit të Republikës, më lejoni t’juaj qartësoj se kjo dispozitë ka qenë e parashikuar edhe në ligjin e mëparshëm të noterisë dhe nuk është konsideruar antikushtetuese. Por ajo që na shqetëson është fakti se kjo ka rezultuar e pazbatueshme në praktikë dhe i është lënë gjithmonë në diskrecion noterit. Po të dëshironte noteri, po të kishte zemër dhe të ishte human, e bënte këtë përjashtim. Nëse nuk dëshironte, nuk e bënte. Për mua kjo duhet të na shqetësojë si ligjvënës, sa ligje që ne miratojmë në Kuvend u japin akses qytetarëve, u lehtësojnë atyre jetën dhe mundësojnë që ata të kenë akses në drejtësi? Më duket se ky ligj nuk është parë në raport me dy ligje të tjera që ne kemi miratuar në kuadër të reformës në drejtësi, konkretisht: ligji nr. 111 i vitit 2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me disa nene të tij dhe ligji “Për tarifatat gjyqësore”.

Të nderuar kolegë, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në nenin 3, shkronja “c”, jep përkufizimin e ndihmës juridike dytësore. Në ndihmën juridike dytësore përfshihet çdo lloj shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimi i këshillimit, i përfaqësimit dhe i mbrojtjes para gjykatës në çështje administrative, civile dhe penale.

Pra, për çdo këshillim ku palët do të marrin pjesë, në proces, kategoritë e parashikuara në këtë ligj, ku përfshihen edhe këshillimet që mund të bëjnë, si për të shitur një pronë, për të hapur një dëshmi trashëgimie e të tjera, janë të mbuluara nga ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Në nenin 3 të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në shkronjat “h” dhe “j” përcaktohet edhe përjashtimi nga tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore si një formë e ndihmës juridike falas. Gjithashtu, ligji përcakton një numër jashtëzakonisht të zgjeruar të kategorive që përfitojnë

ndihmë ligjore falas, qoftë ndihmën parësore dhe atë dytësore. Ne kemi qenë këtu të gjithë bashkë dhe kemi rënë dakord për ta zgjeruar rrethin e personave. Pra, nuk përfitojnë vetëm personat që nuk kanë të ardhura ose janë me ndihmë ekonomike, por përfitojnë edhe disa kategori të tjera, të cilat, pavarësisht gjendjes ekonomike të tyre, janë viktimë e abuzimit, e trafikimit, e dhunës në familje, e diskriminimit, pra përfitojnë automatikisht, pavarësisht të ardhurave të tyre personale.

Kjo bën sens, pasi në nenin 76 kur bëhet fjalë për përjashtimin nga shpenzimet noteriale duhet t'i kemi parasysh këto dy ligje që ju përmenda, por njëkohësisht edhe rregullat që mund të jenë për uljen e tarifave noteriale për këto kategori, por që Dhoma Noteriale i përcakton të domosdoshme. A mund të ofrohet çdo shërbim falas? Kurrësi jo, sepse bie ndesh me atë argument që na ka përmendur Presidenti i Republikës lidhur me nenin 65, që noterët rëndohen shumë të paguajnë sigurimin e profesionit të tyre dhe nuk mbajnë në konsideratë përfitimet ose fitimet e tyre. Në këtë mënyrë janë nonsens argumentet që nga njëra anë kërkohet të paguajnë sa më pak për sigurimin e profesionit të tyre, se nuk kanë shumë aktivitete dhe nga ana tjetër thuhet se nuk jepet ndihma ose të gjitha veprimet falas për aktet nënligjore për njerëzit në nevojë.

Sa më sipër, duke vlerësuar argumentet e paraqitura për nenin 76, vlerësoj se edhe këto argumente nuk qëndrojnë.

Si përfundim, i nderuar zoti kryetar, të nderuar kolegë, duke vlerësuar argumentet e paraqitura në dekretin nr. 11054, datë 14.01.2019 të Presidentit të Republikës, vlerësojmë se nuk ka asnjë bazë kushtetuese. Duke vlerësuar nenet e kontestuara konstatojmë se ato janë hartuar qartë dhe në përputhje harmonike me gjithë dispozitat e tjera të ligjit, prandaj ftoj anëtarët e komisionit të votojnë kundër dekretit të Presidentit. Njëkohësisht, do t'ju kërkoja që menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë në bashkëpunim me misionet ndërkombëtare, që do të asistojnë Dhomën për të përgatitur aktet nënligjore, të respektojnë të gjitha afatet për hartimin e akteve nënligjore brenda 9 muajve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Kolegë, do t'ju lutesha kolegëve, që sipas Rregullores ta ndajmë fazën e pyetjeve dhe të diskutimeve!

Nëse nuk ka pyetje kalojmë në diskutime e kështu me radhë që të jemi korrekt.

Po, për procedurë.

Silva Caka – Faleminderit!

Unë kisha një pyetje për ju, zoti kryetar, gjithmonë në kuadrin e procedurës. A keni të ftuar sot nga Ministria e Drejtësisë? Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë janë një nga palët më të rëndësishme për këtë ligj, prandaj do të doja të dija nëse i keni kërkuar dhe nëse jo cila është arsyeja që nuk janë sot prezentë?

Ulsi Manja – Jemi në fazën e diskutimit të dekretit të Presidentit të Republikës, jo të ligjit “Për noterinë”. Natyrisht është një nga projektligjet e reformës në drejtësi, sigurisht është iniciativë deputeti e Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk është diskutuar në kuadrin e një projektligji të ardhur nga qeveria. Sot jemi në fazën e shqyrtimit të dekretit të Presidentit të Republikës dhe në komision janë prezentë: përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Euraliusit dhe relatorja e projektligjit. Për këto arsye nuk i kemi ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Ju lutem, siç e thashë edhe në fillim, të qartësojmë fazën e pyetjeve!

Zoti Bylykbashi ka pyetje.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke marrë spunto nga ajo që tha kolegja Caka dhe nga përgjigja juaj, se nuk është ligj që vjen nga qeveria, në fakt, ministri i Drejtësisë ka një rol të rëndësishëm në këtë histori, në delegimin që i bëhet këtij pushteti publik te noterët. Ju mendoni se këtu është më e rëndësishme të pyetet Dhoma e Noterisë apo të pyetet ministri për atë kompetencë që delegon dhe problemet që ngre Presidenti i Republikës?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Në fakt, ju nuk keni qenë pjesë e diskutimit të këtij projektligji...

(Diskutime pa mikrofon)

Diskutimi për ligjin ka mbaruar. Ministria e Drejtësisë, por edhe Dhoma Kombëtare, Euraliusi dhe deputetët e Komisionit të Ligjeve e kanë ezauruar diskutimin në lidhje me ligjin e noterisë. Sot jemi në shqyrtimin e dekretit të Presidentit dhe diskutimi është arsyen e kthimit të ligjit.

Oerd Bylykbashi – Meqë ju po bëni këtë lloj sqarimi, dekreti i Presidentit mbi bazën e kompetencës kushtetuese është që i kthen parlamentit për rishqyrtim ligjin. Pra, nuk është çështja thjesht e dekretit, por dekreti i sjell parlamentit në vëmendje për të parë se ligji ka këto probleme. A do ta rivotoni ligjin kështu siç është me 50%+1, që është detyrimi minimal? Pra, kjo është pyetja dhe çështja që ngrihet, ndërsa ju thoni se kemi harruar ta thërrasim. Problemi është i tillë që ministri i Drejtësisë ka një nga funksionet kryesore deleguese, i cili delegon kompetencat te noterët,

përndryshe noterët nuk e kanë këtë. Ku e bëni ju dallimin midis dekretit dhe ligjit, sepse ne jemi duke diskutuar rishqyrtimin e ligjit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Në fakt, dallimin nuk e bëj unë, por e bën neni 96, pika 2 e Rregullores, në të cilin thuhet: “Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e ngritura nga Presidenti i Republikës”.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju kërkoni të bëni debat me mua pse nuk është ftuar Ministria e Drejtësisë. E doni shumë ju Ministrinë e Drejtësisë dhe ju dhimbset pse nuk e kemi ftuar? Apo doni të mbron Presidentin e Republikës me argumentin pse nuk është ftuar ministri i Drejtësisë?

Zoti Braho, e ka kërkuar fjalën për procedurë.

Spartak Braho – Në fakt, fjalën nuk e kam kërkuar për procedurë, por dua t’i drejtoj një pyetje përfaqësues së Dhomës së Noterisë. Çfarë mendimi ka Dhoma e Noterisë për vërejtjet që ka bërë Presidenti?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zonja Sadushi e dha mendimin e Dhomës, por gjithsesi meqë jemi në fazën e pyetjeve, zonja Sadushi mund të përgjigjeni.

Zonja Sadushi, fjala për ju.

Mimoza Sadushi – Edhe një herë dua t’ju përmend faktin se ne si Dhomë nuk jemi dakord me vërejtjet që ka bërë Presidenti, sepse mendojmë se të gjitha këto vërejtje kanë gjetur zgjidhje në projektligj.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Zoti Naço, e ka fjalën.

Nasip Naço – Faleminderit!

Në draftin e paraqitur nga ekspertët e nivelit të lartë të reformës në drejtësi, Komisionit të Ligjeve i është paraqitur një draft me rreth 30 nene dhe ky komision ka shtuar dhe rreth 110 nene të tjera. Do të doja të dija sa nene janë propozuar nga relatorja, sa nga Ministria e Drejtësisë dhe sa nga përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Avokatisë? Pra, ne duhet të kemi parasysh ekspertët e nivelit të lartë, sepse dikush këtu pa u konsultuar me askënd shton edhe 110 nene të tjera. Kjo gjë edhe mund ta ketë përmirësuar projektligjin, por do të dija kontributin e gjithsecilit.

Mund të ketë ndodhur që ekspertët e parë mund t'i kenë marrë paratë gabimisht dhe ju i keni mburrur, duke i dekoruar si ekspertët më të mirë, pastaj vjen pjesa e administratës së Kuvendit që i shton edhe 110 nene të tjera. Pra, dua të di kontributin e gjithsecilit, e para.

E dyta, a janë paguar këta ekspertë të dytë për këtë punë voluminoze që kanë bërë? Sepse, po ta shohësh nga ana e volumit, është një punë goxha e madhe dhe me një të rënë të lapsit kanë hedhur poshtë punën e gjithë ekspertëve më të mirë të reformës në drejtësi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Ju lutem, zonja Hysi, përgjigjen do t'ia jap unë kolegut Naço!

Siç jua thashë edhe më parë, nuk jemi në fazën e diskutimit në parim dhe të miratimit nën për nen të ligjit “Për noterinë”, ky diskutim ka mbaruar, zoti Naço. Po të kishit qenë të pranishëm në fazën e diskutimit në parim dhe në miratimin nën për nen të këtij ligji, do ta kishit marrë edhe përgjigjen e pyetjes që ju bëtë. Kjo gjë është ezauruar, prandaj nuk dua të bëj debat...

Nasip Naço – Zoti kryetar, para një viti në këtë sallë i kam bërë po të njëjtën pyetje relatores dhe pas një viti erdhi dhe u shtua... Unë kam thënë: “Po qarkullon drafti si libër i verdhë në ambientet e Kuvendit dhe nuk na vihet në dispozicion për të parë, për të diskutuar, për të shtuar, për të prapësuar në lidhje me objektin e këtij projektligji”. Pra, është punuar në ilegalitet për të na sjellë një ligj.

Keni procesverbalin e seancës ku kam bërë të njëjtën pyetje para një viti. Pra, nga 30 nene në atë kohë ishte me 60 nene, ndërsa sot e keni bërë me 145. Është punë e mirë voluminoze, por është bërë në ilegalitet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Është e vërtetë që ju në të gjitha diskutimet e projektligjeve të paketës së reformës në drejtësi keni bërë të njëjtën pyetje dhe sa herë e keni bërë këtë pyetje e keni marrë përgjigjen konkrete. Sigurisht, veprimtaria e komisionit është veprimtari e hapur, është transparente, janë procesverbalet, janë mediet që na ndjekin, është edhe opinioni publik, kështu që nuk mendoj se një paketë e rëndësishme e ligjeve, siç janë ligjet e reformës në drejtësi është miratuar në ilegalitet, prandaj këtu nuk ndaj të njëjtin mendim me ju. Gjithsesi, ky është qëndrimi juaj.

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Caka.

Silva Caka – Faleminderit!

Në fakt, kam disa pyetje për relatoren ose edhe për iniciatorët e projektligjit. Në nenin 61 nuk del qartë, për aq sa kuptohet nga formulimi, se si do të emërohet apo se si do të bëhet konkursi për të përzgjedhur zëvendësnoterin. E para.

Ulsi Manja – Pasi zonja Caka të mbarojë pyetjet mund të jepni përgjigjet.

Silva Caka – E dyta, po ashtu nuk del e qartë se kush do të mbajë përgjegjësi në rastet e një dëmi të shkaktuar, sepse jam duke folur edhe për nenin tjetër, që është neni 65, për një përgjegjësi të mbajtur nga zëvendësnoteri. Kjo përgjegjësi, në rastet e dëmeve që shkakton noteri dhe në momentin që atij i pezullohet licenca nga kush do të mbahet? Në këtë rast është zëvendësnoteri, në qoftë se ai do të vazhdojë të funksionojë si një noter me licencën, vulën, me të gjitha atributet që ka noteri dhe që administron zyrën, në momentin e pezullimit të licencës. Me çfarë titulli do të vazhdojë të funksionojë zëvendësnoteri?

Njëkohësisht, më pas detyrimet fiskale, tatimet, taksat, si dhe detyrime që mund të lindin nga shkaktimi i një dëmi, kush do t'i paguajë, noteri, zëvendësnoteri, kompania e sigurimeve? Këto janë disa nga pyetjet e mia dhe më pas do ta ruaj fjalën edhe për diskutim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Hysi, ju lutem, shkurtimisht!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Në radhë të parë neni 61, dua të ripërsëris edhe një herë atë që ju thashë në paraqitjen e relacionit, bën fjalë për dy kategori. Në rastin e noterit të pezulluar zyra e tij mund të menaxhohet nga zyra e zëvendësnoterit kur kjo zyrë ka pasur një zëvendësnoter ose nga një noter që caktohet nga ministri i Drejtësisë. Në gjithë frymën e ligjit...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, dëgjoni apo nuk dëgjoni?

Unë po ju them se nëse zyra e noterit ka zëvendësnoter....

Ulsi Manja – Ju lutem, mos ndërhyri që të marrin edhe përgjigjen!

Vasilika Hysi – Ta mbaroj fjalën, sepse ma preu në mes, e bën zëvendësnoteri. Se si përcaktohet apo zgjidhet një zëvendësnoter e thashë që në fillim janë një sërë nenesh, duke filluar nga neni 5 deri në nenin 15. Ligjin, meqenëse zonja nuk ka qenë e pranishme gjatë shqyrtimit të tij, është mirë ta lexojë para se të bëj pyetje. Pra, një zëvendësnoter nuk bëhet siç është sot,

zëvendësnoteri duhet të kalojë një konkurs për të hyrë një herë në formimin e detyrueshëm fillestar që është një vit, më pas...

(Diskutime pa mikrofon)

Po ia shpjegoj meqë nuk e ka lexuar ligjin.

E dyta, do të bëj dy vjet praktikë profesionale.

E treta, do të japë një provim dhe do të marrë licencën dhe do të quhet zëvendësnoter.

E katërta, zëvendësnoteri nuk emërohet nga ministri i Drejtësisë, zgjidhet nga noteri. Pra, në këtë nen ka dy raste, kur zyra ka një zëvendësnoteri, rregulli është që e zgjedh vetë noteri. E dyta, është kur Dhoma nuk ka zëvendësnoter.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, po përsëris atë që kam thënë!

Neni 66, flet për të drejtat dhe detyrat e zëvendësnoterit. Zëvendësnoteri, në këtë nen ka 6 paragrafë ku thuhet të drejtat, përgjegjësitë, kush mban përgjegjësi, si vepron zëvendësnoteri e të tjera.

Ulsi Manja – Zonja Hysi, ju lutem, jo shumë detaje për ligjin, sepse ligji është diskutuar në komision!

Vasilika Hysi – Meqë ata nuk kanë qenë të pranishëm, po ua shpjegoj.

Ulsi Manja – Ju lutem, fokusohuni te përgjigjet e pyetjeve që ju bëri zonja Caka!

Vasilika Hysi – Mbarova.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Çupi.

Më pas kalojmë në diskutime.

Dhurata Tyli (Çupi) – Faleminderit, zoti Manja!

Nëse do ta shohim në dy këndvështrime, në këndvështrimin politik tashmë e kemi marrë përgjigjen e shumicës, pasi para 10 ditësh grupi ka dalë me një vendim për rrëzimin e dekretit. Pra, nuk kemi asnjë lloj diskutimi politik, pasi ju e keni vendosur dhe nuk e merrni parasys.

Sa i takon çështjes teknike, doja të pyesja zonjën Sadushi: Dekreti i Presidentit ose kthimi i ligjit nga ana e Presidentit e përmirëson apo e përkeqëson ligjin?

Ulsi Manja – Zonja Sadushi, një përgjigje të shkurtër.

Mimoza Sadushi – Nuk mund të them se as e përmirëson dhe as e keqëson, por mund t’ju them se ligji i ka parashikuar të gjitha, prandaj nuk kemi pse t’i ndryshojmë këto nene.

(Diskutime pa mikrofon)

Dhurata Tyli (Çupi) – Presidenti reagon me disa vërejtje, a e përmirëson apo e keqëson?

Mimoza Sadushi – Më falni, doja t’ju sqaroja vetëm një gjë. Në nenin 61 thuhet shumë qartë: “Kur noteri ka një zëvendësnoter në zyrë, kjo zyrë do të administrohet nga zëvendësnoteri. Në rastet kur nuk ka zëvendësnoter, ministri cakton një noter tjetër”. Kjo është mëse e qartë dhe nuk mendoj se ka ndonjë gjë për t’u diskutuar. Nuk mund t’ju them as që e keqëson apo e përmirëson, përderisa ligji i ka të parashikuara gjërat pse duhet t’i rikthehemi përsëri këtyre neneve.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kalojmë në fazën e diskutimeve.

Kush e do fjalën?

Zonja Caka, e ka kërkuar fjalën.

Silva Caka – Faleminderit!

Të bësh një ligj me 145 nene, të cilat në tërësinë e tyre nuk përcjellin negativitetet dhe të fusësh aty vetëm 3 nene, ose më mirë të themi 2 nene, se nuk dua të flas për nenin 76, me një tendencë kaq negative sa për ta kthyer ligjin në partiak ose klientelist, do të thotë që ose ke mbushur xhepat, ose je para një presioni jashtëzakonisht të madh për të vënë këto dy nene.

Së pari, për nenin 61 dhe zëvendësnoterin nuk ishin të kota pyetjet, pavarësisht se unë nuk e vë fare në diskutim shpjegimin shterues të pedagoges sime, Mendoj se emërimet për zëvendësnoter qoftë nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, qoftë me ndërhyrjen e Ministrisë së Drejtësisë do të na kthehen po njësoj si ato emërimet në sektorin e burgjeve, të cilave iu doli nami deri te “Zëri i Amerikës”. Pra, do të bëhet e njëjta praktikë sipas së cilës do të fusni njerëzit tuaj dhe me pak fjalë zëvendësnoterin nuk do ta bëni një njeri në funksion të noterit, i cili do të ndihmojë atë në çështje administrative ose veprimtari të përditshme, por do ta ktheni në një spiun, i cili do të vijë dhe do t’ju thotë ju te partia se çfarë bën filan ose filan noter. Kjo për arsye se zëvendësnoteri do të zgjidhet pa konkurs nga noteri, ndërkohë që ju bëni një listë dhe ne e dimë fare mirë si do të shkojë ajo listë, e dimë shumë mirë se kush do të dalë fitues në ato lista, dhe, në mos e zgjedh noteri, do t’ia çojë ministrja. Këtu implikonin ministrin e Drejtësisë dhe Dhomën e Noterëve, e cila, kjo e fundit, nuk e dimë a do që të implikohet në këtë gjë dhe të dalë te “Zëri i

Amerikës”. Pra, do të çoni aty njerëz, të cilët mund të vijnë nga fondacioni “Qemal Stafa”, anëtarë të forumeve tuaja rinore, domethënë këta do të dalin dhe do të jenë zëvendësnoterë, të cilët pastaj do të vijnë te partia e do t’ju thonë ju çfarë po bën filan noter.

Së dyti, është i gjithë problemi i lidhur me detyrimet, sepse në një moment kemi një noter që ka detyrime financiare, në një moment kemi një noter që përmbush detyrime lidhur me palët të treta apo dëmet që shkakton. Një noter në momentin që shkakton një dëm ka dispozita të tjera, siç mund të jenë ato në Kodin e Procedurave Penale, ose në Kodin e Procedurave Civile si përgjigjet qoftë para palëve, qoftë para ligjit, qoftë para gjykatës, ose qoftë para vetvetes.

Ju shtoni edhe sigurimin e profesionit. Nuk ka asgjë të keqe në sigurimin e profesionit. I gjithë problemi është që e bëni ligj klientelist. Sigurimi i profesionit në çdo vend të botës dhe në çdo lloj profesioni, që ka nevojë të sigurohet, bëhet në mënyrë vullnetare, ju e bëni në mënyrë të detyrueshme dhe implikoni aty edhe Dhomën Kombëtare të Noterëve. Kështu që, me pak fjalë, sigurimin, përveçse të detyrueshëm, e ktheni në një tender. Pra, Dhoma e Noterëve do të hapë tenderin, do të zgjidhni kompanitë e sigurimeve, që unë jam e sigurtë që do të jetë ALBSIG-u, pasi e dimë shumë mirë që e kujt është ajo kompani, ose ndonjë kompani tjetër, që u privatizua në kohën kur kishit ministrat tuaj, Gjijnuri dhe Ahmetaj, të cilët kanë pjesë ose kanë aksione të përcaktuara. Kështu që kjo është e gjithë çështja me nenet 61 dhe 65.

Pra, ky ligj kthehet në një ligj partiak ku ju do të bëni emërimet dhe do të keni spiunët tuaj në të gjitha dhomat e noterëve dhe, mbi të gjitha, do të bëni një ligj klientelist, pastaj do të lidhni një kontratë, e cila nuk është vullnetare, do të jetë totalisht e detyrueshme dhe do të përcaktoni ju cila do të jetë kompania që do të fitojë. Mbi të gjitha do të jetë ministria që do të përcaktojë qoftë dyshe-menë, qoftë tavanin e tarifave të sigurimit.

Aktualisht në Shqipëri janë 250 noterë. Ai që ka paguar për të sjellë nenin 65, do t’ju përcaktojë edhe tarifën dhe do të na e sillni pastaj me vendim të ministrit.

250 noterë do të marrin 100 mijë lekë të vjetër që mund të jetë në vite ose në muaj, ose si do ta përcaktojë Etlida dhe do t’iu mbushen xhepat atyre që mbi të gjitha nuk mbajnë as edhe një përgjegjësi në raste dëmsh. Janë pikërisht këto kompani sigurimesh, të cilat ju nuk i keni thirrur as përfaqësitë tyre, madje nuk kemi përfaqësues sot as nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare, as nga Byroja Kombëtare e Sigurimeve, për një arsye të vetme se opinioni i tyre kolektiv nuk do të përputhej me opinionin e atij që ka sjellë këtë nen. Është vetëm një kompani që ju ka sjellë këtë

nen, që bën këtë ligj klientelist dhe që lekët me vendim të Etildës ose Dhomës Kombëtare të Noterisë pastaj çohen tek ato kompani që, në fakt, nuk shpërblejnë asnjëri.

Enkelejd Alibeaj- Të gjithë e kuptojnë se këtu po luhet një teatër hipokrit. Këtu nuk bëhet fjalë për tri dispozita që ka kthyer Presidenti i Republikës me shumë të drejtë. E keni detyruar Presidentin e Republikës, në mungesë të të gjithë instrumenteve institucionale, të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast, të marrë përsipër t'i tërheqë veshin me të drejtë parlamentit edhe në çështje të teknikës legislative. Në fakt, në këtë gjendje ka rënë sistemi institucional i Republikës së Shqipërisë pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, parlamenti ka rënë e ka rënë, madje edhe Komisioni i Ligjeve sapo ka rënë, sepse, me gjithë respektin e madh për Dhomën e Noterëve, në një karrige aty duhej të ishte i ftuar edhe përfaqësuesi i qeverisë. Ministri i Drejtësisë, jo se kemi ndonjë dashuri të madhe për ministrat e kësaj qeverie, por për ministrinë, për interesin publik, do të duhej të ishte aty për të mbrojtur interesin publik. E di që kjo është kërkesë e sforcuar, por, së paku, për të mos e bërë teatër hipokrizie.

Çështja që është e rëndësishme, megjithëse të gjitha ato që përfaqësuesi i presidentit tha janë të rëndësishme, është që Presidenti i Republikës i ka kthyer parlamentit një ligj dhe në çfarëdo lloj republike normale, situatë normale të veprimtarisë institucionale kjo do të duhej të ishte një kampion alarmi dhe jo vetëm kaq, por parlamenti do të duhej ta merrte...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Do ta mbaroj unë dhe do ta kuptosh.

Tani, parlamenti qoftë për postin që ka Presidenti i Republikës, qoftë për simbolikën që përfaqëson, qoftë edhe për zellin që duhet gjithkush të tregojë për korrektësinë kushtetuese të ligjbërjes, do të duhet ta marrë seriozisht për shkak të interesit publik. Për sa kohë që ai që është Presidenti i Republikës për Kryeministrin tuaj është thjeshtë I.M., e kuptoj se kjo është derexheja se ku ka rënë shteti, republika, arsyeja shtetërore. Ju nuk po bëni asgjë për të mbajtur së paku atë që quhet arsyeja pse kemi shtet dhe Kushtetutë. Çdo gjë këtu është e paragjykuar. E ktheu Presidenti i Republikës, nuk pritet ta thotë Ulsi, as deputetët e Komisionit të Ligjeve, por e thotë ai nga godina matanë. Po e ktheu presidenti, i vihet kryqi, sepse nuk duron çfarëdo lloj qortimi minimal që mund t'i vijë nga institucionet e tjera, sepse nuk kupton nga shteti, sepse nuk kupton nga Kushtetuta. Nuk më çudit aspak sjellja e atij, mua më çudit sjellja e atyre që prezumohen të jenë të votuar nga publiku që duhet ta mbrojnë interesin publik. Kjo është e para prandaj është teatër hipokrizie.

Së dyti, dhe kjo është edhe më e rëndësishme, ky është një nga ligjet e reformës në drejtësi. Publiku duhet ta mbajë mend. Në 40 ligjet e mëparshme të reformës në drejtësi, njëri prej tyre është ky, i nisur, siç zoti Naço e tha, me një sërë amendamentesh të diskutuara edhe në Komisionin e Reformës në Drejtësi, që do të duhej të ishte ai autoriteti i vetëm, produkti i vetëm që do të duhej të kishte sjellë miratimin ose jo të atij projektligji. Çfarë ndodh? Ka filluar diskutimi në këtë komision në tetor të vitit 2017 dhe ka përfunduar në tetor të vitit 2018. Një vit ka zgjatur diskutimi për një projektligj, edhe kur opozita nuk ishte, se sikur të ishim ne që t'ju bëheshim pengesë, edhe kuptohej. Keni pasur të gjithë komoditetin për të bërë një ligj të mirë. Çfarë keni bërë? Keni bërë pazar. Nga 30 nene, i ratë një kryq të madh reformës në drejtësi, me tamtame e pompozitet dhe bëtë një ligj nga e para si pazar.

Unë e kuptoj tundjen e kokës së zonjës Sadushi. Ka të drejtë, ajo përfaqëson noterët dhe ka të drejtën të jetë e kënaqur. Kështu duhet të funksionojë, por pyetja është po interesin e publikut kush e mbron? Po të gjithë ata hallexhinj, të cilët shkojnë në gjykata dhe prokurori thjesht dhe vetëm se një noter i pakontrolluar, i papërgjegjshëm, i korruptuar me një aktnoterial me një kontratë të bën gjëmën, të merr pronën, të falsifikon dokumentet e tenderit. Historia e "DhAlbania", që ka falsifikuar tenderin për 40 milionë euro për 2 kilometra rrugë, do të shkojë deri te ai fakiri noter dhe ajo përkthyesja dhe të gjithë faturën do t'ua vënë atyre, sepse ata e kanë fajin, nuk e ka fajin Kryeministri, Gjyknuri, Qendro. Në fakt, të gjithë këta do të marrin paratë e shqiptarëve, por do të gjejnë fakirin noter dhe do t'ia japin të gjithë faturën atij këtë bëni edhe me ligj.

Pra, çështja e reformës në drejtësi shkon në një pazar për të mbrojtur interesat klienteliste. Po publiku? Ai nuk ka të drejtë, nuk ka dinjitet, ai thjesht shtypet, abuzohet, vidhet në vullnetin e vet, mashtrohet. Kjo është situata e shkruar dhe e noterizuar tani me ligjin për noterinë.

Tri dispozita ka nxjerrë Presidenti i Republikës, që tregojnë edhe thelbin e gjësë. Neni 61 tregon thelbin e këtij ligji. Ky shtet me të gjitha problemet e veta së paku për sistemin e noterisë ka pas vendosur një balancë midis interesit publik dhe ushtrimit të veprimtarisë së noterit. Noteri është funksionar publik, nuk është privat, ushtron një detyrë publike, çdo hap noterial është akt i shtetit shqiptar, ushtrohet në mënyrë private nga noterit. Çështja e parë që duhet t'i vijë në mend atij që mbron interesin publik, shtetin, parlamentin, qeverinë, Ministrinë e Drejtësisë është si të mos lejojë që noterët, të cilët i futen rrugës së paligjshmërisë, të abuzojnë me pushtetin publik. Si kontrollohen? Çfarë kanë bërë këta me ligjin? Këta i kanë hequr të gjithë kompetencat Ministrisë

së Drejtësisë. Kudo në Europë instrumenti që duhet të mbartë interesin publik për të mos lejuar praktika korruptive dhe antiligjore për noterët është ministri i Drejtësisë. Është një standard i konsoliduar prej vitesh. Çfarë kanë bërë me ligjin për prokurorinë? E la mënjanë Ministria e Drejtësisë shtetin. Ju thashë nuk kam simpati për ministrat e Drejtësisë, por për ministrinë, për shtetin, për ligjin duhet të kemi të gjithë merak për t'i mbrojtur. Nuk përfundon këtu Ministria e Drejtësisë me atë zonjë që është. E papjekur, siç është, sigurisht nuk e mban dot këtë barrë të madhe.

Ulsi Manja- Ju lutem, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Do të duhet dikush që të interesohet për këtë çështje. E kanë lënë si një rregullim privat të noterisë. Një porcion të pushtetit, të interesave të publikut ua lanë noterëve. Mes tyre ka shumë njerëz të nderuar, por një pyetje ose një analizë minimaliste duhej ta kishte bërë Ministria e Drejtësisë. Sa çështje gjyqësore të shqiptarëve hallemëdhenj, që burojnë vetëm nga shkeljet e ligjit të noterëve shkojnë në gjykata dhe qytetarët rropaten? Pa fund. Ky ishte një rast i mirë që minimalisht këtë potencial të madh konfliktesh gjyqësore me këtë ligj së paku ta eliminonim. Kjo është ta shohësh veprimtarinë parlamentare dhe ligjin si mundësi të mirë për t'i shërbyer interesit publik. Çfarë keni bërë ju në nenin 65? Keni bërë një gjë fare të thjeshtë, nuk ka përgjegjësi më as parlamenti, as qeveria, as ministria, por çdo noter ose zyrë noteriale do të duhet të sigurohet që po shkaktoi dëm paratë t'ia japë atij që i ka shkaktuar dëm. Është e vërtetë ajo që zonja Caka tha se kushdo e kupton që interesi nuk është publik në këtë rast, është privat. Ndonjë shoqëri sigurimesh është ajo që, ka lobuar për ta futur këtë dispozitë në mënyrë që të gjithë noterët e republikës të detyrohen të paguajnë tarifa sigurimi të shoqëritë e sigurimit. Kurrsesi nuk ka për të ndodhur ndonjëherë që, nëse një noter i shkakton një dëm një privati, ai të marrë përsipër ta dëmshpërblejë. Dispozita ka qenë më parë, por, siç e tha zonja Hysi, nuk ka funksionuar. E vetmja gjë e shtuar është detyrimi i noterëve që të shkojnë te shoqëritë e sigurimit. Besoj se edhe këtu tenderi është bërë se cili oligark e ka fituar të drejtën për t'i siguruar.

Së treti, me të drejtë Presidenti i Republikës ka thënë që po për fakirët, ata që nuk kanë të paguajnë tarifat e kripura të noterëve, kush mendon? Asnjë. Këtu mendohet vetëm për ata që kanë para, oligarkët që do të marrin tenderin e sigurimit të noterëve, dhe për noterët, sepse e ushtrojnë profesionin në mënyrë private. Këtu mungon pjesa tjetër e balancës, shqiptarët që nuk kanë të paguajnë, ndërkohë që ky palo shtet shton përditë e më tepër procedura burokratike

administrative, për një dokument banal do të duhet të shkosh te noteri dhe të paguash që të bëjë punë.

Këto janë arsye të forta për ta marrë seriozisht zilen së cilës i ka rënë Presidenti i Republikës. Kaq ka të drejtë ai, ta kthejë në parlament për ta parë jo si qortim ose sfidë ndaj krenarisë suaj politike, siç bën ky nga godina matanë, por na bën thirrje ne për sa kohë që jemi bartës (nuk jemi siç duket, bartës të sovranitetit të publikut), ta shohim me dashamirësinë më të madhe për të rregulluar për aq sa ç'është e mundur këtë çështje. Ka të drejtë Presidenti i Republikës, sepse sot tre vjet nga reforma në drejtësi sistemi i prokurorisë ka rënë, sistemi i drejtësisë kushtetuese ka rënë, i Gjykatës Kushtetuese ka rënë, sistemi i Gjykatës së Lartë ka rënë dhe me këtë ligj bie edhe sistemi i noterisë.

Presidenti i Republikës së paku në këtë rast është treguar në lartësinë detyrës.

Për sa kohë që këta vrapojnë në mënyrë të ethshme për të rrëzuar çfarëdolloj sistemi që mban në këmbë republikën e shqiptarëve, ka vetëm një zgjidhje, shqiptarët të rrëzojnë këtë sistem korruptiv që përfaqësohet nga këta me shpresën e madhe, me aspiratën e madhe për të rindërtuar edhe një herë, ashtu siç Europa do, një sistem normal të një republike normale, në kushtet kur të gjitha mjetet kanë rënë: mjetet parlamentare, mjetet e sistemit të drejtësisë, mjetet e debatit parlamentar. A e shihni, këta kanë marrë vendimin, por këtu bëjnë teatër, as kanë ndër mend të dëgjojnë se çfarë thotë presidenti ose përfaqësuesit e opozitës. Kjo është zgjidhja për shqiptarët, për ata që shkojnë te noterët, për ata që u vidhet prona, që u vidhet pasuria dhe që shkojnë dhe hidhen në kalvarin e gjykatave. Të gjithë do të duhet të dalin e të marrin fatin e tyre në dorë në datat 16, 17, 18. Ai, i cili ka drejtuar këta, u thotë që Presidenti i Republikës është vetëm një I.M, ai duhet hedhur në koshin e plehrave të shqiptarëve.

Ulsi Manja- Unë, në fakt, dua t'i kthej një përgjigje kolegut Braho që u mërzit. Zoti Braho, i kam dhënë fjalën opozitës që deri në datën 16 do ta mbledh komisionin përditë që të bëjnë thirrje për protestën e 16 shkurtit.

Fjalën e ka zoti Naço.

Nasip Naço – Sigurisht që neni 86 i Rregullores përcakton qartë diskutimin që bëhet sot për dekretin e Presidentit, brenda detyrimeve që ka sjellë Presidenti, unë jam dakord me diskutimin e zonjës Caka për sa parashtroi në lidhje me projektligjin.

Pyetjet e mia në fillim ishin për të përcaktuar propozimet dhe shtesat që i janë bërë këtij projektligji. Pra, na u tha që drafti ishte pjesë e reformës në drejtësi. Ekspertë të nivelit të lartë

sollën një draft me rreth 30 nene dhe sot shikojmë që ligji i miratuar është me 145 nene. Pyetjet e mia ishin edhe për relatorin, edhe për përfaqësuesit e EURALIUS-it, edhe për Dhomën Kombëtare të Noterisë, po të ishte përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, të njëjtën pyetje do t'i bëja edhe asaj zonje, por unë e kuptoj se pse nuk e keni thirrur, se nuk ka asnjë lloj kontributi në këtë ligj.

Pyetjet e mia ishin për nenin 61, 65, 76. Kush i ka propozuar këto nene?

Vota ime do të jetë pro dekretit të Presidentit, por, krahas kësaj, unë kam edhe një problem tjetër shumë serioz, që ka të bëjë me qytetarët, pasi nga dega e Thesarit në Skrapar, në kundërshtim me çdo akt ligjor dhe nënligjor, është bllokuar veprimtaria financiare dhe kanë ngelur pa u furnizuar me ushqim konviktet, çerdhet dhe i qendrës me aftësi të kufizuara...

Ulsi Manja – Po kjo s'ka lidhje me dekretin kjo...

(Diskutime pa mikrofon)

Nasip Naço – Unë pyetjen po ia bëj ministres së Financës, se e ka dorëzuar interpelancën, në bazë të nenit 97, urgjentisht.

A do të bllokohet thesari vetëm në Skrapar, apo do të vazhdojë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

A ka diskutime të tjera?

Nuk ka.

Përpara se ta hedhim në votim dekretin e Presidentit, dua të them dy fjalë në lidhje me dekretin.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

E para, ligji dhe fryma e ligjit, që ka marrë konsulencën më të mirë të ekspertëve vendas dhe të misionit EURALIUS, shkon në drejtim të disiplinimit të shërbimit të noterisë në Shqipëri. I jep fund kaosit në këtë shërbim.

E dyta, ligji synon uljen e numrit të noterëve. Për ata që e kanë lexuar ligjin dhe që kanë qenë pjesë e diskutimit të këtij ligji të rëndësishëm, ligji synon uljen e numrit të noterëve, që sot, të dashur qytetarë, janë 478 noterë në shërbimin e noterisë në Shqipëri.

Në qendër të ligjit vendoset rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Në qendër të këtij ligji nuk është noteri, por është qytetari. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, që ky shërbim, i deleguar nga shteti, do t'ju japë qytetarëve të RSH-së.

Sa për ilustrim dhe se cili është qëllimi ynë si maxhorancë me miratimin e këtij ligji, më lejoni t'ju jap disa shifra faktike:

Në 2007-2013, besoj e dini shumë mirë se nuk kemi qeverisur ne, është gjetur shërbimi i noterisë me 204 noterë. Nuk e di kush kanë qenë ministrat e Drejtësisë së asaj kohe, por në këtë periudhë kanë dhënë 102 licenca noterësh.

E morëm ne pushtetin në vitin 2013, por periudha 2013-2017, të dashur qytetarë, e nderuar medie, ju e dini që Ministrinë e Drejtësisë në qeverinë tonë e kanë pasur vëllezërit tanë të vegjël të dikurshëm. Po sa licenca kanë dhënë? Në vitin 2013 dhanë 57 licenca, në vitin 2014 dhanë 54, në vitin 2015 e kanë bërë pushim se ishin zgjedhjet lokale, në vitin 2016, në nxitim e sipër dhanë 58 licenca, kurse në vitin 2017, nga shtatori i kanë futë një treshe. Në total janë 172 licenca.

I solla këto shifra për të thënë që shërbimi i noterisë nga viti 2007, se nuk po filloj nga viti 2005 në mandatin e parë qeverisës të kolegëve opozitarë, shërbimi i noterisë ka fluturuar me 278 noterë në periudhën 2007-2017. Më e bukura është se keni licenca në Baldushk, në Qafë-Krrabë, në Paskuqan, në Babrru, në Tujan e kështu me radhë.

Ne prandaj erdhëm te ky ligj, sepse jemi maxhorancë e përgjegjshme, sepse duam një shërbim noterie cilësor, duam një shërbim noterie që t'i ofrojë qytetarit shërbimin më të mirë të mundshëm dhe jo si deri më sot, që e njëjta pronë e paluajtshme dhe ju i dini rastet e ndjekjeve penale dhe të ndëshkimit në gjykata, kur një apartament është shitur dhjetë herë. Nuk e kam shitur unë, asnjëri nga kolegët e mi, por kanë ndodhur në këtë shërbim.

Prandaj ky ligj, për hir të së vërtetës, ka ngrënë shumë kohë në fazën e draftimit, të diskutimit dhe të miratimit nen për nen. Është shumë e vërtetë ajo që thotë kolegu Naço, që ka ardhur në fillim me pak dispozita, por falë kontributit të Dhomës Kombëtare të Noterisë, të kolegëve të mi deputetë, të ekspertëve vendas dhe të huaj kemi ardhur në një ligj që është i standardeve më të mira europiane, por që, sigurisht, do të jetë praktika, puna e përditshme e noterëve në RSH që do të japë notën për cilësinë e këtij ligji që ne kemi miratuar.

Ka shqetësime nga më të ndryshmet dhe disa u paraqitën sot edhe nga kolegët e mi deputetë. Unë nuk e di si i bëjnë këto llogari dhe nga burojnë këta shqetësime, por di një gjë, se për ata që e kanë lexuar ligjin, edhe kontrata kolektive, edhe sigurimi i noterit, e thotë qartë ligji, e vendosin 2/3 e Asamblesë së Përgjithshme, ku marrin pjesë 478 noterë të Shqipërisë dhe në rast se 2/3 e noterëve të noterëve të Shqipërisë do të vendosin për të bërë një sigurim kolektiv në një

kompani të caktuar, le ta vendosin, është shërbim i lirë, është organizim i lirë, është vullneti i asamblesë së noterëve.

Unë do të kisha dashur që diskutimi për këtë ligj të ishte teknik, për ato tri arsye për të cilat e ka kthyer Presidenti, sepse diskutimi politik është mbyllur.

Maxhoranca e ka marrë vendimin politik, edhe në momentin kur e miratoi ligjin, edhe në momentin kur u njoh me arsyet e kthimit të ligjit nga ana e Presidentit të Republikës.

Janë të gjitha këto arsye, të nderuar kolegë, të nderuar qytetarë, pse unë bashkohem me sugjerimin e koleges Hysi, që dekreti i Presidentit duhet rrëzuar.

Duke ju falënderuar për durimin që patët për të më dëgjuar, hedh në votim dekretin e Presidentit të RSH-së.

Kush është pro rrëzimit të dekretit të Presidentit, nr.11054, datë 14.1.2019?

10 pro. Kush është kundër? 3 kundër. Abstenime? Nuk ka.

Rrëzohet dekreti i Presidentit të RSH-së, nr.11054, datë 14.1.2019 “Për kthim dhe rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.110 të vitit 2018 “Për noterinë””.

Me këtë votim e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!